

30 studentë të Universitetit "Eqrem Çabej" dhe Universitetit të Tiranës janë diplomuar në përfundim të shkollës verore, e organizuar në kuadër të bashkëpunimit mes dy universiteteve nga Njësitë bazë të Historisë dhe Filologjisë në UGJ dhe Njësia Bazë e Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë në UT.

Në fokus të ligjëratave të mbajtura nga pedagogët e këtyre dy universiteteve ishte historia e Shqipërisë në periudhën 1945 - 1990, sidomos ato ngjarje dhe fakte që kanë të bëjnë me krimet gjatë regjimit komunist.

Ligjëratat u mbajtën në vendet ku kanë ndodhur këto ngjarje, si në ish - kampin e internimit në Tepelenë dhe në Kalanë e Gjirokastrës.





